

KËRKESË
Nr.7477, datë 16.12.2011

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurisë së paluajtshme pronë private, në truallin që ndodhet në Muzeun Historik Kombëtar “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, Krujë.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Muzeu Historik Kombëtar “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, Krujë. Me anë të këtij publikimi kërkohet të vëmë në dijeni personin i cili preket nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për pronarin sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronari që ka emrin në listën emërore, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, ka të drejtë të paraqesë pretendimet e tij të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë kompetente (Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve).

Në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”, të gjithë pronarët do të shpronësohen pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Vlera totale e këtij shpronësimi është 3 480 000 (tri milionë e katërqind e tetëdhjetë mijë) lekësh.

MINISTRI I TURIZMIT, KULTURËS, RINISË
DHE SPORTEVE
Aldo Bumçi